



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Ruror  
REPUBLICA E KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratën e parashikimit  
Odeljenje za Opštu Upravu  
Nr. i prot. 1257 Më 05.04.2024  
III- Br. prot. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RUROR  
RAHOVEC - ORAHOVAC

# Raport i punës

## TM1/2024



## Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	3
Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars.....	3
Aktivitet në muajin janar.....	3
Aktivitetet në muajin shkurt.....	4
Aktivitetet në muajin mars.....	5
Projektet e investimeve kapitale .....	5
Kanalet e kullimit .....	5
Pastrimi i përrrenjëve .....	6
PËRFUNDIM.....	6

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2024, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitetet të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve.

### Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitetesh.

Aktivitetet të cilat kryhen vazhdimesht, siq janë pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermer që dëshmon se janë prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt Janar, Shkurt dhe Mars etj.

Ndërsa aktivitetet më kryesore paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

#### Aktivitet në muajin janar

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: **15 janar deri më 13 shkurt 2024**.
- Gjithësej kanë aplikuar **91** blegtore, me gjithsej: **1,709,950** litra qumësht dhe **522** krerë të viçave për majmëri
- Kemi mbajtuar kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2023. Shumë fermer kanë pasur probleme me llogari bankare ku është kërkuar nga ne që të i ndryshojmë në mënyrë që të realizojnë pagesat e tyre po ashtu i kemi informuar fermerët për çdo informacion që ata kishin nevojë.
- Është nënshkruar kontrata me Qendrën Grumbulluese "Agro Celina", në vitin 2024 e cila do të furnizojë buqit me Fidane dhe inpute tjera për kulturën e trangullit "Kornishan". Përmes kësaj marrëveshje do të mbulohen: Fidanet cilësore të trangullit, Plehërimi dhe Riplehimi (kristalorët), Pesticidet, Mulqerimi (Folia e zezë), Sistemi i ujitjes pikë-pikë.



# Raport i punës | janar-mars 2024

- Është nënshkruar kontrata “Furnizim me preparate për luftimin e insektit cikadia të hardhisë së rrushit”
- E kemi përfunduar raportin vjetor, të cilin e kemi publikuar në webfaqen e Komunës.
- E kemi përfunduar Cash planin për vitin 2024.
- Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2023.
- Kemi pranuar kërkesa nga fermerët për vlerësim të dëmit të Serrave nga erërat e forta, komisioni ka dalur në terren për vlerësim.
- Kemi mbajtur takim me komisionin nga Agjensioni Pyjor, të cilit i kemi bartur kompetencat për stafin e Pylltarisë.

## Aktivitetet në muajin shkurt

- Komisioni ka vazhduar me daljen në terren për vlerësimin e dëmeve të serrave.
- Kemi mbajtur takim me përfaqësuesit lidhur me projektit “Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si ndërmarrëse bujqësore në Kosovë” të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe bashkë-financuar nga Brot für die Welt e qe po implementohet nga Syri i Vizonit (SiV). Ku 6 prej aplikusve janë nga komuna e Rahovecit. Ata na kanë kërkuar një zyrtar të DBPZHR-së për të qenë pjesë e komisionit të vlerësimit të projekteve për Startup.
- Veterinari i punësuar në DBPZHR, ka filluar me vaksinimin e bagëtive falas për të parandaluar sëmundjet infektive, gjatë këtij muaji janë vaksinuar rreth **1900** krerë lopëdhe **6500** dele.



## Aktivitetet në muajin mars

- Nga 6 mars deri më 20 mars, ka qenë e hapur hapur thirrja për aplikim: Përkatja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit. Gjithsej kanë aplikuar 500 fermerë Vreshtarë.



- Më 13 mars është hapur aplikimi për pagesa direkte/subvencione për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. Për sektoret, të cilët do të mbështeten përmes Programit për Pagesa Direkte 2024, afati per aplikim është i hapur deri më 12 prill 2024, në ora 16:00.
- Gjatë gjithë javës së dytë të këtij muaji jemi angazhuar me mobilizimin e zyrave në Ratkoc dhe Krushë të Madhe, poashtusi drejtori kemi bërë kërkesë për hapjen e userave për zyrtarët të cilët pranojnë aplikacione të bujqëve.
- Aplikimi ka vazhduar gjith muajin mars, ndërsa deri më 31 mars kanë aplikuar rreth 2000 fermerë (70%).

## Projektet e investimeve kapitale

### Kanalet e kullimit

**Kanali i Kullimit në Ratkoc** – me fillimin e përmirësimit të kushteve atmosferike, kanë rifilluar punimet në ndërtimin e kanalit të tokave bujqësore në segmentin e dytë sipër fshatit Ratkoc, ku njëkohësishtë është bërë edhe pastrimi, e poashtu edhe në segmentin e tretë nga lagja e Morina në drejtim të hekurudhës.

**Kanali i Kullimit nga Shtavica deri ne Fortese** – për shkak të prurjeve të mëdha të sasis së ujit në këtë projekt për këtë periudhë reportuese nuk është punuar në ndërtim të kanalit, përveç në pastrim të skrapateve dhe heqjes së dheut në pjesën ku është punuar në fund të vitit të kaluar. Me përmirësim të kushteve atmosferike pritet të rifillojnë punimet

**Kanali i Kullimit ne Qifllak** – Kompania që ka kontratë me komunën tonë është rikthyer në punishtë dhe ka filluar punimet në ndërtim të kanalit përgjatë hekurudhës si dhe në Aksin 2 në lagjen thaqi. Punimet janë duke vazhduar.

# Raport i punës | janar-mars 2024

## Pastrimi i përrenjëve

Edhe në këtë peridhë raportuese kemi pranuar kërkesa nga përfaqësisesit të fshatrave dhe lagjeve të qytetit, ku këto kërkesa janë trajtuar me kujdes dhe ato të cilat janë aprovuar kemi ndërmarrur veprime dhe kemi intervenuar në disa pozicione në pastrim si: përroi në fshatin Dobidol nga hekurudha deri te lumi Drini i Bardhë, përroi në fshatin Dejn nga hekurudha deri te Drini i Bardhë, pastrimi i sipërfaqes nga fshati Fortesë deri në fshatin Sapniq, kemi intervenuar në një segment në Rahovec në lumin Rimnik etj.

## PËRFUNDIM

Ky raport përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermerë në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre.

Zyrtarët kanë qenë të gatshëm për çdo vlerësim dëmi me të cilët fermerët e komunës sonë ballafaqohen, ata dalin në terren në qdo fatkeqësi natyrore që ndodh dhe dëmon kulturat bujqësore.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionistë të fushave, me theks të veçantë inxhiner të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohem i dëshmorët e zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

05.04.2024

Rahovec

